



PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL, SHQIPËRI, FAZA III

Skema Pilote Rajonale e Granteve publikuar më 11 prill 2018

“PYETJE & PËRGJIGJE”/ 1

8 maj 2018

1. Cilat janë dokumentet shoqëruese që duhen dorëzuar nga aplikantët e përzgjedhur?

Aplikantët e përzgjedhur do të njoftohen me një letër zyrtare nga Autoriteti Kontraktues ku do t'u kërkohej të paraqesin edhe dokumentet e mëposhtëm për të vijuar me tej me kontratën e grantit:

- Vendimi i Këshillit Bashkiak për të zbatuar Projektin për të cilin është akorduar granti i PZHRSH, me mandatin e Kryebashkiakut për të nënshkruar kontratën e grantit;
- Për projektet e investimit, një konfirmim mbi pronësinë e pasurisë së paluajtshme (ju lutemi, referojuni pyetjeve dhe përgjigjeve nr. 5 dhe nr. 6 më poshtë);
- Plani i prokurimit publik i përditësuar për projektin me draft-dosjet e tenderit bashkëlidhur;
- Një formular identifikimi financiar i aplikantit kryesor (jo nga bashkë-aplikanti(t) i certifikuar nga banka tregtare (bankë e nivelit të dytë) ose dega e Thesarit tek e cila do të kryhen pagesat. Në rastin kur një bankë tregtare përzgjidhet nga aplikanti, kjo bankë duhet të ndodhet në Shqipëri.

Aplikantëve kryesorë u rekomandohet fuqimisht që të nisin përgatitjen e dokumenteve shoqëruese menjëherë pas dorëzimit të aplikimit të tyre, kështu që këto dokumente të jenë të disponueshme datën e njoftimit të akordimit të grantit.

2. Sa e gjatë është periudha e zbatimit të projektit? E përfshin ajo periudhën e prokurimit?

Bazuar në vlerësimet e afateve kohore për secilin hap të Skemës Pilote Rajonale të Granteve të PZHRSH-së, faza e zbatimit të projekteve fillon menjëherë pas nënshkrimit të kontratës së grantit. Vlerësohet që periudha e zbatimit të projektit është 153 ditë kalendarike, përfshirë periudhën e prokurimit.

3. Mundet kjo skemë të financojë projekte të infrastrukturës apo shërbimeve rurale, si sistemet e vaditjes së fushave, veçanërisht shumë të nevojshme për bashkitë e vogla të cilat kanë nevojat më të mëdha në sektorin rural?

Zhvillimi rural nuk është i lejueshëm në këtë skemë grantesh.

4. Cili është ndryshimi midis një bashkie që është aplikant kryesor dhe një bashkie që është në rolin e bashkë-aplikantit?

Një bashki në rolin e aplikantit kryesor, nëse nuk ka bashkë-aplikant do të përkufizohet si përfitues i Kontratës së Grantit.

Bashkia(të) në rolin e bashkë-aplikant(ët) do të emërtohen si partnerë zbatues pas akordimit të grantit, ndërsa bashkia në rolin e aplikantit kryesor do të identifikohet si koordinatori, në kontratën e grantit.

Koordinatori i kontratës së grantit do të menaxhojë fondet e grantit si dhe do të paguajë kostot që lidhen me aktivitetet e realizuara nga bashkë-aplikant(ët), në linjë me aktivitetet dhe kostot e parashikuara në projekt. Rrjedhimisht, në rastin kur ka një bashkë-aplikant, koordinatori duhet të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi me bashkë-aplikantin që do shërbejë si bazë ligjore për rregullimin e këtyre transaksioneve.

Aplikanti kryesor dhe bashkë-aplikant(ët) duhet të jenë brenda të njëjtës zonë së zhvillimit rajonal.

- 5. A mundet një bashki të aplikojë për rikonstruksionin/rehabilitimin e ndërtesave për të cilat ajo ka të drejtën e përdorimit, por nuk ka pronësi mbi pronën? Pronësia gjendet në inventarin e bashkisë, por nuk mund të paraqitet çertifikata e pronësisë.**

Në rastin në fjalë, aplikanti kryesor duhet të paraqesë një dokument që dëshmon të drejtën ligjore të përdorimit të pronës përkatëse. Kjo pronë duhet të jetë publike, që do të thotë, prona duhet t'i përkasë një enti tjetër publik.

- 6. A mundet një bashki të aplikojë për rikonstruksionin/rehabilitimin e objektit/ndërtesës së trashëgimisë kulturore nëse ka një memorandum bashkëpunimi përmes të cilit Ministria e Kulturës e cila është enti përgjegjës për objektin/ndërtesën, i delegon bashkisë përkatëse të drejta të caktuara mbi objektin/ndërtesën?**

Kjo është e mundur me kusht që pronësia t'i përkasë një enti publik. Memorandumi i bashkëpunimit që përcakton të drejtën e përdorimit të trashëgimisë kulturore, ose dokumenti i cili evidenton detyrimin për ta mirëmbajtur trashëgiminë kulturore, do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktues në përputhje me seksionin 2.2.4 të Thirrjes për Propozime gjatë dorëzimit të dokumenteve shoqëruese për aplikimet e përzgjedhura përkohësisht.

- 7. Sa projekte mund të financohen për secilën Zonë të Zhvillimit Rajonal?**

Fondi total i skemës prej 822.000 EUR është ndarë në mënyrë të barabartë midis zonave të zhvillimit rajonal, ku për secilën zonë janë të disponueshme 205.500 EUR.

Vlera e granteve është midis 24.000 EUR dhe 60.000 EUR (përfshirë TVSH). Duke qenë se të gjitha bashkitë mund të aplikojnë për grante, nuk mund të bëhet në këtë fazë një vlerësim se sa projekte mund të financohen në secilën zonë të zhvillimit rajonal.

- 8. E përfshin TVSH-në vlera e grantit?**

Po. TVSH është një kosto e lejuar në Skemën Pilote Rajonale të Granteve të PZHRSH-së dhe si e tillë është përfshirë në vlerën e grantit.

- 9. Çfarë lloj procedurash prokurimi duhet të përdorë një bashki pas akordimit të grantit?**

Bashkitë përfituese të grantit, pas nënshkrimit të kontratës së grantit do të vijojnë procedurat e prokurimit bazuar në legjisllacionin shqiptar të prokurimi publik.

- 10. Mundet një bashki të aplikojë për më shumë se një projekt propozim?**

Një Bashki në rolin e aplikantit kryesor mund të aplikojë me vetëm 1 projekt. Një Bashki mund të jetë në rolin e bashkë-aplikantit në 1 ose më shumë projekte.

11. Nëse ofertat që do të kërkojë aplikanti nga furnitorët e ndryshëm për të justifikuar vlerësimin e kostove të projektit janë në Lekë, me çfarë kursi do të konvertohen ato në Euro, apo këto oferta duhet të jenë në EUR?

Buxheti për projektin duhet të hartohet në Euro. Në lidhje me këtë, në seksionin 2.2.6 të Formularit të Aplikimit përfshihen udhëzimet si vijon: “Ju lutem, vini re se kosto e veprimit dhe kontributi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues duhet të shprehet në EUR. Në rast se aplikanti e ka vlerësimin e kostove në monedhën shqiptare, kursi i këmbimit 1 EUR = 134,15 Lekë duhet të përdoret për shkëmbimin e monedhës në EUR”.

12. Parashikohet bashkë-financimi i grantit nga aplikanti?

Grantet nën këtë skemë do të mbulojnë 100% të vlerës së projektit nëse kjo është midis vlerës minimale dhe maksimale të grantit. Në rast se kostot e parashikuara janë nën apo të barabarta me vlerën maksimale të grantit, nuk kërkohet bashkë-financim nga aplikanti. Një bashki mund të propozojë një projekt me kosto të vlerësuar më të lartë se 60.000 EUR. Në këtë rast kjo bashki do të bashkë-financojë nga buxheti i saj kostot që nuk mbulohen nga granti i PZHRSH-së.

13. Ka ndonjë prioritet në vlerësimin e projekt-propozimeve?

Skema Pilote Rajonale e Granteve e PZHRSH-së është e hapur për të gjitha bashkitë e Shqipërisë të cilat mund të aplikojnë për projekte në linjë me 5 tipologjitë e projekteve të Thirrjes për Aplikime. Në aplikim duhet të specifikohet qartësisht se cila/cilët tipologji projekti adresohen nga propozimi. Të pesta tipologjitë konsiderohen njësoj si prioritete të Programit.

14. A shtohet vlera e grantit në rastin kur ka më shumë se një aplikant?

Nuk ka rritje të vlerës së grantit në rastin kur një bashki aplikon me bashkë-aplikant(ë). Edhe në këtë rast, vlera e lejuar e grantit mbetet midis 24.000 EUR – 60.000 EUR.

15. Lejohet që bashkitë të krijojnë partneritet jashtë zonës përkatëse të zhvillimit rajonal?

Bashkitë mund të krijojnë partneritet vetëm brenda së njëjtës zonë të zhvillimit rajonal.

16. A mund të na qartësoni rregullin rreth buxhetit për shpenzimet e vizibilitetit?

Shtojca B e Thirrjes për Aplikime, worksheet 1 (faqja 1) “Buxheti për Projektin”, përmban parashikimin që aktivitetet për komunikimin dhe vizibilitetin duhet të jenë të paktën sa 3% e totalit të kostove të lejuara dhe këto aktivitete duhet të planifikohen dhe buxhetohen siç duhet për çdo fazë të zbatimit të projektit.

17. Si mund të garantohet një aplikant për transparencën e procesit të vlerësimit?

Procesi i vlerësimit rregullohet me një procedurë të detajuar. Vlerësimi kryhet nga vlerësues të miratuar të cilët duhet të respektojnë rregullat e përcaktuara të konfidencialitetit dhe paanesisë. Për më tepër, raportet e vlerësimit do të verifikohen nga PZHRSH përpara se rezultatet t'u njoftohen aplikantëve.

18. Në cilin format duhet të jenë dokumentet e aplikimit të versionit elektronik?

Dokumentet në versionin elektronik, duhet të jenë në format të paeditueshëm, PDF ose të skanuara, përveç buxhetit (Shtojca B e Thirrjes për Aplikime) që duhet të jetë në format të editueshëm excel. Versioni elektronik duhet të jetë identik me dokumentet e printuara të paraqitura në zarf.

19. Mund të shpjegoni si kryhet pikëzimi në procesin e vlerësimit nëse pikët maksimale janë shumëfish i numrit 5?

Tabela e vlerësimit është e ndarë në seksione dhe nën-seksione. Secilit nënseksion do t'i jepet një pikëzim midis 1 dhe 5. Kur pikëzimi maksimal është shumëfish i 5, vlerësuesit do të caktojnë një vlerë midis 1 dhe 5 dhe më tej kjo vlerë do të shumëzohet me 2 në rastin kur maksimumi është 10, me 3 në rastin kur maksimumi është 15 dhe me 4 në rastin kur maksimumi i pikëve është 20.

20. Si mund të paraqitet një ankesë mbi procesin e vlerësimit?

Ankesat për rezultatin e procedurës së vlerësimit mund të dërgohen pranë Autoritetit Kontraktues. Letra e ankesës duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i aplikantit dhe duhet të paraqesë arsyen e ankesës. Në parim, duke marrë në konsideratë faktin se Autoriteti Kontraktues ka kontrolluar raportet e vlerësimit përpara se të njoftohen rezultatet e vlerësimit tek aplikantët, ankesat duhet të fokusohen në gabime proceduriale. Përgjigjet duhet të jepen maksimalisht brenda 15 ditëve kalendarike që nga data e marrjes së ankesave. Letra e ankesës duhet të skanohet dhe të dërgohet me e-mail pranë rdpa@rdpa.al, si dhe me postë tek PZHRSH, Rr. Dervish Hima, Kulla Ada, Kati 4, Tiranë.

21. Do të marrin ndonjë shpjegim aplikantët që nuk përzgjidhen mbi arsyet e përjashtimit të tyre nga akordimi i grantit?

Pas finalizimit të procesit të vlerësimit, secili aplikant i përzgjedhur do të njoftohet për rezultatet nga Autoriteti Kontraktues. Ky njoftim do të përmbajë shpjegime të detajuara pse aplikimi nuk u përzgjedh për financim dhe është refuzuar apo nuk është përfshirë në listën rezervë.

22. A do të publikohet lista e projekteve të përzgjedhura?

Lista e projekteve të përzgjedhura do të publikohet si në faqen e PZHRSH-së ashtu edhe në faqet respektive të Agjencive për Zhvillimin Rajonal.

23. Në çfarë gjuhe duhet të aplikojnë bashkitë?

Bashkitë duhet të aplikojnë në Shqip, përveç "Përmbledhjes Ekzekutive" (pjesë e formularit të aplikimit) që duhet të jetë në gjuhën Shqipe dhe atë Angleze.

24. Mundet një bashki të aplikojë për një grant "Për të ndërtuar një qendër për fëmijët me aftësi të kufizuara"? Është ky një projekt i lejuar nën këtë skemë grantesh?

Në linjë me seksionin 2.1.2 të Thirrjes për Aplikime mbi Projektet e lejuara, ndërtimi i një qendre për fëmijët me aftësi të kufizuara është i lejuar duke qenë në linjë me tipologjinë e projektit nr. 3.

25. Cili është ndryshimi midis output-it dhe rezultateve? Mund të jepni një shembull?

Output-i është një produkt i prekshëm si rrjedhojë e projektit, ndërsa rezultati është një efekt i output-it. Për shembull, output-i për projektin e rikonstruksionit të një shkolle mund të jetë "500 metra katrorë të rehabilituara brenda ndërtesës së shkollës", ndërsa rezultati do të ishte "përmirësimi i kushteve të mësimdhënies dhe nxënies për mësuesit dhe nxënësit në klasat e shkollës". Numri i përfituesve përfundimtarë nga projekti, pra, numri i mësuesve dhe studentëve që do të përfitojnë nga projekti, duhet mundësisht të paraqitet.

26. Bashkitë do të paraqesin një projekt apo vetem një aktivitet?

Projekt-propozimi i Bashkisë duhet të përshkruhet duke përdorur formularët e Shtojcës A dhe Shtojcës B të Thirrjes për Aplikime të publikuar në faqen e internetit www.rdpa.al. Projekt-propozimi mund të fokusohet në një ose më shumë aktivitete të lejuara sipas nevojës për të arritur output-et dhe rezultatet e parashikuara.

27. Nëse rast se një projekt propozim përzgjidhet dhe firmoset kontrata e grantit, a do të çelet llogari më vete pranë një banke tregtare (bankë e nivelit të dytë) apo granti do të menaxhohet përmes llogarisë së Bashkisë në thesar?

Bashkia që përfiton një grant mund të hapë një llogari të dedikuar në një bankë tregtare (bankë e nivelit të dytë). për të kryer transaksionet financiare përkatëse.

28. Është i lejuar një projekt që fokusohet në rikonstruksionin e godinës së zjarrëfikëses?

Bazuar në Thirrjen për Aplikime seksioni 2.1.2 mbi Projektet e lejuara, rinovimi i godinës së shërbimit të zjarrëfikëses, mund të lejohet në linjë me tipologjinë e projekteve nr.5, kjo nëse ndërtesa ka si qëllim të mbështesë ofrimin e shërbimeve esenciale që janë të nevojshme për sigurinë dhe mirëqënien shëndetësore të komunitetit. Projekte që fokusohen vetëm në rinovimin e godinave për zjarrëfikësit nuk lejohen. Ju lutemi referojuni pyetjes dhe përgjigjes nr.5 në lidhje me të drejtat ligjore të përdorimit të pronës.

29. Çfarë dokumenti kërkohet që të dorëzohet për projektin, përveç aplikimit të plotësuar?

Ju lutemi referojuni dokumenteve në vijim të kërkuara në Shtojcën A të Thirrjes për Aplikime me titull “Formulari i Aplikimit të Grantit” seksioni 2.2.4:

Për të gjitha procedurat e prokurimeve që janë planifikuar më poshtë në tabelën 3 dhe që duhet të plotësohen nga aplikanti - që është Plani Prokurimit të projektit - aplikanti duhet të paraqesë **bashkëlidhur me aplikimin e tij** dokumentet në vijim, duke demonstruar gatishmërinë për realizimin e projektit:

- a) Në rast punimesh ndërtimi, dizajni i projektit të jetë i miratur, specifikimet teknike etj. gati për të marrë lejen/autorizimin për fillimin e ndërtimit. Veçanërisht, për përmirësimin e infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara, aplikanti duhet të sigurojë të gjitha dokumentet e nevojshme që dëshmojnë se projekti është i përshtatshëm për këtë grup të synuar.
- b) Në rast të blerjes së materialeve (pajisjeve ose diçka tjetër), specifikimet teknike;
- c) Në rast shërbimesh, përfshi mbikqyrjen e punimeve, nevojiten termat e referencës.

Rrjedhimisht, aplikimi duhet të paraqitet me dokumentet e mësipërm bashkëlidhur, si dhe me buxhetin e plotësuar. Nuk kërkohen dokumente të tjera shtesë.

30. Si do të plotësohet Shtojca B në formular në lidhje me kostot e parashikuara për punimet, pajisjet dhe shërbimet? Cili është kuptimi i tipologjisë së punimeve, blerjes së materialeve dhe shërbimeve? Si do të ndahen këto kosto mbi bazë tremujori?

Tipologjia e kostove për ‘punimet, blerjen e materialeve dhe shërbimet’ i referohet kostove të vlerësuara për punimet përkatëse, blerjen e materialeve dhe kontratat e shërbimit të përfshira në planin e prokurimit të projektit. Këto kosto duhet të paraqiten për secilin tender, duke përdorur një linjë buxheti për secilin nga tenderat e parashikuar. Vlera në kolonën “Kosto totale neto” do të jetë për vlerën e parashikuar të kontratës përkatëse; nëse është e mundur, output-et konkretë të kontratës do të përfshihen në kolonat “njësia matëse”, “sasia”, “kosto / njësi” për shembull: njësia matëse: metër katror; sasia: 1000; kosto/njësi: 500 EUR.

Ju lutem, vini re se blerja e materialeve mund të përfshijë lloje të ndryshme pajisjesh, mobilim dhe lloje të tjera materialesh.

Ndarja e kostove midis dy tremujorëve varet nga vlerësimet e aplikantit në datën kur do të kryhen pagesat ndaj kontraktorëve.

31. Mund të na shpjegoni çfarë do të mbulohet me artikullin buxhetor ‘Kontigjenca dhe/ ose fondi për luhatjet në kursin e këmbimit’? Për parashikimet e kostos do të përdoret kursi i këmbimit 1 EUR = 134.15 Lekë, kështu që, çfarë duhet të shkruajmë në linjën buxhetore përkatëse?

Fondi i kontigjencës, përdorimi i së cilit duhet të autorizohet paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues, mund të mbulojë ndonjë artikull të paparashikuar të shpenzimeve dhe/ose diferencën mes kostove totale të parashikuara dhe kostove aktuale të tregut. Nisur nga fakti që procedurat e prokurimit do të kryhen në Lekë por parashikimet e kostos në buxhet janë në EUR, disa diferencë midis parashikimeve dhe shpenzimeve aktuale mund të shfaqen dhe kjo duhet të mbulohet nga linja buxhetore në fjalë. Rekomandohet që një rezervë kontigjence prej 5% ose më pak të shumes totale të projektit të përfshihet në buxhet. Në këtë rast, vetëm kolona e fundit dhe rreshti në buxhetin “Total” të tremujorit të 2^{te} do të përdoret, duke i shtuar vlerën e rezervës së parashikuar për kontigjencën. Për shembull, në rast se kostot totale të projektit janë 30,000 EUR, dhe aplikanti alokon përqindjen maksimale të lejuar - 5% - që është e këshillueshme, rezerva prej 1,500 EUR dhe do të shkruhet në kolonën dhe rreshtin e fundit të worksheet 1 (faqja 1) të excel-it, “Buxheti për projektin”. Në worksheet 2 (faqja 2) të excel-it, në seksionin “Justifikimi i buxhetit për projektin”, do të shënohet përqindja e përlogaritur, ndërkohë që nuk ka nevojë të përfshihet asnjë justifikim në kolonën vijuese “Justifikimi i vlerësimit të kostove”.

32. Si do të disbursohen fondet e grantit?

Granti do të paguhet në dy këste, si vijon: pagesa e parë: para-financim deri në 80% të vlerës totale të grantit (përfshirë TVSH), pas firmosjes së Kontratës së Grantit; pagesa e dytë: pagesa e vlerës së mbetur, në përfundim të zbatimit të projektit.